



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 58

Prishtinë, më 14.11.2024, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Hydajet Hyseni- Kaloshi dhe Bahrim Shabani, zëvendëskryetarë, Arijeta Rexhepi, Milazim Salijaj, Enis Kervan, Shemsedin Dreshaj, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Elmi Reçica, Valentina Bunjaku- Rexhepi, Adem Hoxha dhe Fadil Gashi, anëtarë.

Të pranishëm të tjerë: Hysni Mehani, asistent i GP LVV; Orgest Topojani, asistent i GP PDK; Jeta Huraglica, asistente e GP LDK; Leunora Gashi, asistente e GP AAK; Fjollë Haziri, përfaqësuese e KDI-së; Zijush Ahmeti, zyrtar i SKKK dhe Celal Iliaz, përfaqësues i Drejtorisë për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni- Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 8.10.2024;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtura me 8.10.2024.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur me 8.10.2024, miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Mjedis, Ushqim, Bujqësi, Planifikim dhe Zhvillim;

Zëvendëskryetari, në fillim të takimit, i njoftoi anëtarët e komisionit për prezencën e deputetit Milazim Salijaj, duke i shprehur mirëseardhje dhe kontributi juaj do të shtyjë përpara punën në komision.

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjit nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror me amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutim, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni në bazë të rezultateve të votimit: për 7, kundër 0, abstenim 0, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-305 për ofruesin e shërbimeve të navigacionit ajror, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, me raport-amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, me amendamente të Komisionit funksional, dhe kërkoi nga anëtarët e Komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Meqë nuk pati diskutim, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni në bazë të rezultateve të votimit: për 7, kundër 0, abstenim 0, nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr.08/L-291 për Gjykatën Administrative, me amendamente të Komisionit funksional, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohet për miratim në seancë plenare.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, për fushat që janë në fushëveprim të Komisionit

Zëvendëskryetari paraqiti për shqyrtim Projektligjin nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë propozim apo sugjerim.

Enis Kervan, duke u bazuar në Ligjin mbi ndarjen buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe fushëveprimin të komisionit, ai shprehu qëndrimin e tij se do të paraqesë propozimet e tij, që lidhen me kërkesat e komuniteteve joshumicë.

Ai diskutoi se sipas statusit në Këshillin Konsultativ për Komunitete pranë Presidentit, janë të përfshirë 9 komunitete. Sa i përket hyrjes në fuqi të Projektligji për pagat, 27 anëtarët e Këshillin Konsultativ për Komunitete, paguhen me një shumë diskrete nga Zyra e Presidentit, andaj të njëjtin nuk janë të përfshirë në sistemin e pagave për vitin 2025. Ai propozoi që në kategorinë për mallra dhe shërbime, kjo kategori të përfshihet me Projektligjin mbi ndarjet buxhetore për vitin 2025.

Propozimi i dytë ishte, te kategoritë e subvencione, me kod 21200, në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, të alokohen 3 milionë euro për programin e ndërtimit dhe renovimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, si dhe te programi për infrastrukturë për komunitete me, kod 19068, të alokohen 1 milion euro për projektet e infrastrukturës në vendbanimet e komuniteteve joshumicë në Kosovë.

Bahrim Shabani, diskutoi se me Ligjin mbi ndarjen buxhetore për vitin 2025, duhet të parashihet që të mbulohen kërkesat e komunitetit joshumicë.

Duke marrë parasysh situatën e rënduar ekonomike të komuniteteve që jetojnë në Kosovë, propozoi që ndarja buxhetore të jetë në përputhje me kërkesat e komuniteteve, që ndërlidhet me ndërtimin dhe renovimin e shtëpive në komunat dhe vendbanimet, ku jetojnë komunitetet.

Fridon Lala, theksoi se shuma prej 3 milionë euro për programin e ndërtimit dhe renovimit të shtëpive për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, duhet të ndahet në mënyrë proporcionale sipas regjistrimit të komuniteteve në Republikën e Kosovës. Po ashtu, propozoi që mjetet e kërkuara të alokohen nga kontingjentet e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfere.

Për zbatimin e këtij projekti, shpërndarja e mjeteve të planifikohet sipas rajoneve zhvillimore, ku jetojnë komunitetet joshumicë.

Shemsedin Dreshaj, deklaroi se prezenca e tij nuk do të krijojë kuorum në komision, por do të ofrojë disa opinione lidhur me Ligjin për ndarjen buxhetore të buxhetit për vitin 2025.

Në veçanti, diskutoi për prioritetet e sistemit shëndetësor dhe të arsimit. Sipas sistemit buxhetor, GPT në shëndetësi është 3.5%, ndërsa në arsim 3.4%, i cili nuk është i mjaftueshëm për kërkesat e qytetarëve. Në kuadër të këtyre statistika, vazhdojnë pagat të jenë më të ulëta në rajon, në krahasim me shtetet e Bashkimit Evropian, ku GPT për shëndetësi është 6%, ndërsa në arsim 4.7%. Në situatën aktuale, nuk janë adresuar çështjet e përmirësimit të shërbimeve shëndetësore, ende nuk ka sigurim shëndetësor, vazhdon ikja e profesionistëve shëndetësorë, lista e barnave esenciale është e gjatë, dhe për arsyt e cekura, nuk do ta votoj miratimin e projektligjit.

Arijeta Rexhepi, tha se duhet theksuar se Projektligji mbi ndarjen buxhetore për buxhetin për vitin 2025, në vlerë prej 3 miliardë e 600 milionë euro, ka bazë ligjore në rritjen buxhetore të secilit sektor, në veçanti në shëndetësi dhe në arsim. Shpenzimet e paparashikuara janë ndarë në sektorin e shëndetësisë, sidomos sigurimi i listës esenciale të barnave. Klinikat janë riparuar dhe po ndërtohen me standarde.

Sa i përket amendamenteve të propozuara, nuk kemi ndonjë kërkesë të drejtpërdrejtë, bazuar në fushëveprimin e komisionit. Shpresoj se në Komisionin për Buxhet dhe Transfere, ku trajtohen çështjet e linjës buxhetore, do të merrni mbështetjen e të njëjtave.

Amendamentet e propozuara u shqyrtuan nga anëtarët e komisionit dhe të njëjtat nuk u përkrahën.

Pas diskutimeve, zëvendëskryetari e hodhi në votim Projektligjin nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, dhe në bazë të rezultatit të votimit: për 7, kundër 0, abstenim 0, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025, nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe rekomandohen për miratim në seancë plenare.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hydajet Hyseni- Kaloshi,

Zëvendëskryetar i Komisionit